

VENDIM
Nr. 1061, datë 23.12.2015

**PËR MIRATIMIN E RREGULLIT TEKNIK “PËR PAJISJET ELEKTRIKE TË
PROJEKTUARA PËR PËRDORIM BRENDA DISA KUFIJVE TË TENSIONIT”¹ DHE
PËRCAKTIMIN E LISTËS SË STANDARDEVE TË HARMONIZUARA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, pika 17, 5, pika 2, 6 e 42, të ligjit nr.10489, datë 15.12.2011, “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe të ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullit teknik “Për pajisjet elektrike të projektuara për përdorim brenda disa kufijve të tensionit”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara shqiptare, me karakter referues për prezumimin e konformitetit të pajisjeve referuar në pikën 1, sipas listës që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Standardet e harmonizuara shqiptare, numrat dhe titujt e të cilave janë përfshirë në listën e përmendur në pikën 2, të këtij vendimi, shërbejnë si dokumente reference për prezumimin e konformitetit të pajisjeve referuar në pikën 1 me kërkesat thelbësore të sigurisë, të përcaktuara në rregullin teknik që i bashkëlidhet këtij vendimi.
4. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe Ministria e Energjisë dhe Industrisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet e tij nga data 1.1.2016.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

¹*Direktiva Evropiane 2006/95/EC e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, e datës 12 dhjetor 2006 “Për pajisjet elektrike të projektuara brenda disa kufijve të tensionit”, numri Celex: 32006L00955; Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr.374, datë 27.12..2006, faqe 10–19.*